



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government *Ministria e*
Administrimit të Pushtetit Lokal *Ministarstvo*
Administracije Lokalne Samouprave *Ministry of*
Local Government Administration

Prishtinë, 21.08.2017

Thirrje publike për mbështetje financiare të projekteve/programeve të OJQ-ve në avancimin e vetëqeverisjes lokale në Kosovë

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e promovimit dhe zhvillimit të vetëqeverisjes lokale, të aplikojnë me projekte për mbështetje financiare me qëllim të përmbushjes së objektivave të Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026.

2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet e tyre në fushat prioritare, si vijon:

2.1. Rritja e qëndrueshmërisë fiskale të komunave dhe zhvillimi ekonomik lokal;

Projektet në këtë fushë duhet të ofrojnë:

- Aktivitete konkrete që promovojnë bizneset dhe stimulojnë prodhimin vendor;
- Promovimin dhe zhvillimin e sektorit të bujqësisë;
- Mbështetjen e të rinjve dhe grave në zhvillimin e ideve biznesore;
- Angazhimin dhe aftësimin e ndërmarrësve të rinj;
- Projekte inovative me ndikim në zhvillimin ekonomik lokal.

2.2. Qeverisja e mirë (e-qeverisja, legjislacioni);

Projektet në këtë fushë duhet të ofrojnë:

- Promovimin e një administrate profesionale dhe të qëndrueshme në nivel lokal si garanci për ofrimin e shërbimeve kualitative për qytetarë;
- Forcimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në politikbërje në nivel lokal;

- Projekte inovative të cilat përmirësojnë transparencën në komuna dhe rrisin llogaridhënien;

2.3. Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të komunave;

Projektet në këtë fushë duhet të ofrojnë:

- Zhvillimin e kapaciteteve profesionale përmes programeve specifike për trajnim të shërbyesve civil dhe stafit politik;
- Përmirësimin e cilësisë së planifikimit të politikave në nivel lokal dhe në programimin e investimeve;
- Nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet shoqërisë civile dhe komunave në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarë;
- Zhvillimin e kapaciteteve komunale në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike përmes partneritetit publiko-privat;
- Ndërtimin e kapaciteteve për të mbikëqyrë dhe kontrolluar zbatimin e projekteve dhe shërbimeve të ofruara.
- Mbështetjen në zhvillimin dhe përdorimin e sistemeve on-line të shërbimeve që ofrohen nga komunat;

2.4. Forcimi i partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive, gjithëpërfshirëse dhe kohezive

Projektet në këtë fushë duhet të ofrojnë:

- Përfshirjen e qytetarëve në projekte të përbashkëta me komunat;
- Ngritjen e vetëdijes së qytetarëve në kultivimin e ndjenjës së vullnetarizmit;
- Projekte inovative me ndikimin në jetën kulturore, sportive dhe rekreative;

2.5. Promovimi i vlerave të trashëgimisë dhe diversitetit kulturor, natyror dhe social me qëllim të zhvillimit social, ekonomik dhe kulturor në komunë

Projektet në këtë fushë duhet të ofrojnë:

- Promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në komuna;
- Promovimin e turizmit rural dhe vlerave të pasurive komunale me qëllim të zhvillimit socio-ekonomik;
- Demonstrimi i avancimit të barazisë gjinore dhe përfshirjen sociale të grupeve të marginalizuara në proceset e zhvillimit në nivelin lokal;

3. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 46 mijë euro

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është 1000 euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 5000 euro.

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune, nga data 21.08.2017 deri me datën 11.09.2017.

6. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti 1 projekt në kuadër të kësaj thirrje.
7. Periudha e zbatimit të projektit ndërlidhet me vitin fiskal 2017, apo deri më 8 Dhjetor 2017. E njëjta OJQ mund të jetë partnere në disa projekte në fushat prioritare të thirrjes.
8. Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku {p.sh. një vit} para datës së publikimit të thirrjes publike.
9. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e vetëqeverisjes lokale.
10. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.
11. Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.
12. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare (web faqja: www.).
13. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme:

Adresa Ish ndërtesa e Rilindjes Katet: 10, 11, 12 dhe 13 Prishtinë, Republika e Kosovës;
tel: +383(0)200 35567 ; 35598; 35577; e-mail: info.mapl@rks-gov.net;
14. Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.
15. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.
16. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: e-mail: info.mapl@rks-gov.net

